



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 23
19.06.2017

NR. VENDIMI 20
23.06.2017

VENDIM
“Në emër të Republikës”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e përbërë prej:

Luan HASNEZIRI – Kryesues

asistuar nga sekretare **Lavdie HYSAJ**, në Tiranë, sot me datë 23.6.2017, mori në shqyrtim penale me palë:

KËRKUES: 1. XH.D (D), i datëlindjes XX.XX.XXXX, banues në lagjen X, Plazh, apartamenti nr. XX, shkalla X, Durrës, përfaqësuar në gjykim në bazë të prokurës së posaçme Nr. 2256 Rep, Nr. 1383 Kol, datë 27.12.2016 nga avokat L. L. .
2. S.D, i datëlindjes XX.XX.XXXX, banues në lagjen X, Plazh, apartamenti nr. XX shkalla X, Durrës, përfaqësuar në gjykim në bazë të prokurës së posaçme Nr. 2256 Rep, Nr. 1383 Kol, datë 27.12.2016 nga avokat L.L.
3. S.D, e datëlindjes X.X.XXXX, banues në lagjen X, Plazh, apartamenti nr. X, shkalla X, Durrës, përfaqësuar në gjykim në bazë të prokurës së posaçme Nr. 2256 Rep, Nr. 1383 Kol, datë 27.12.2016 nga avokat L. L. .

PERSON I TRETË: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga prokurore Dolereza Musabelliu.

OBJEKTI: Revokimin e masës së sekuestros të vendosur me vendimin Nr. 25, datë 2.12.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, mbi pasuritë e mëposhtme:

1. Pasuri e paluajtshme nr. XX/XXX+X-XX, e llojit Apartament, me adresë, lagja X Plazh, Durrës, vol.XXX fq. XXX, e ndodhur në Zonën kadastrale nr. XXXX, me sipërfaqe 75 m², e cila, figuron në emër të shoqërisë ndërtuese “XXXX”sh.p.k., por që në fakt, është e blerë prej shtetases S.D.
2. Pasuri e paluajtshme e llojit Njësi, me sipërfaqe 32.5 m², e ndodhur në zonën kadastrale nr. XXXX, lagja X Plazh Durrës, e cila, nuk figuron e regjistruar në Z.V.R.P.P. Durrës, dhe ndodhet në një pallat të ndërtuar nga shoqëria “XXX” Sh.p.k, në truallin e shtetases SH.A.T, ku, ky truall sipas kontratës sësipërmarrjes, figuron i regjistruar në Z.V.R.PP. Durrës dhe ka numër pasurie XX/XXX, vol XX , fq XX dhe është blerë nga shtetasi S.D.
3. Pasuria e paluajtshme nr. XXX/X, e llojit are + truall, me sipërfaqe 420 m², nga kjo trualli zë

300 m2, dhe ndërtesë 81 m2, e regj në vol. X fq XXX, zona kadastrale XXXX, ndodhur në XXXXX, Berat, e cila figuron në pronësi të shtetasit S.D.

BAZA LIGJORE: Neni 13 i ligjit Nr.1092, datë 03.12.2019 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen, administroi provat, dëgjoi në diskutimin përfundimtar përfaqësuesin e posaçëm të kërkuesve, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit, pasi dëgjoi prokuroren, e cila, ishte dakort që të pranohet kërkesa e kërkuesit;

VËREN:

1. Me vendimin Nr. 25, datë 2.12.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, është vendosur:

- Sekuestrimi i pasurive të mëposhtme:

1. Pasuri e paluajtshme nr. XX/XXX+X-XX, e llojit Apartament, me adresë, lagja X Plazh, Durrës, vol.XXX fq. XXX, e ndodhur në Zonën kadastrale nr. XXX, me sipërfaqe 75 m², e cila, figuron në emër të shoqërisë ndërtuese “XXXX”sh.p.k., por që në fakt, është e blerë prej shtetasës S.D.

2. Pasuri e paluajtshme e llojit Njësi, me sipërfaqe 32.5 m², e ndodhur në zonën kadastrale nr. XXXX, lagja X Plazh Durrës, e cila, nuk figuron e regjistruar në Z.V.R.P.P. Durrës, dhe ndodhet në një pallat të ndërtuar nga shoqëria “XXXX” Sh.p.k, në truallin e shtetasës SH.A.T, ku, ky truall sipas kontratës së sipërmarrjes, figuron i regjistruar në Z.V.R.P.P. Durrës dhe ka numër pasurie XX/XXX, vol XX , fq XX dhe është blerë nga shtetasi S.D.

3. Pasuri e paluajtshme me Nr. XXX/X, e llojit are + truall, me sipërfaqe 420 m², nga kjo trualli zë 300 m², dhe ndërtesë 81 m², e regj në vol. X fq XXX, zona kadastrale XXXX, ndodhur në XXXXX, Berat, e cila figuron në pronësi të shtetasit S.D.

2. Prokroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, pasi ka realizuar hetimin pasuror për pasuritë e sekuestruara, me vendimin e mësipërm të gjykatës, me vendimin e saj, të datës 2.6.2017, ka vendosur: Pushimin e procedimit pasuror me Nr. XX/X, të vitit 2016, në ngarkim të shtetasave XH.D, S.D dhe S.D, sepse, në sipas vlerësimit të saj, nuk plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e këtyre pasurive.

3. Në vendimin e saj për pushimin e procedimit pasuror ndaj shtetasve XH.D (D), S.D dhe S.D, organi i akuzës, ndër të tjera, arsyeton:

“...- U provua se pasuria me Nr. XX/XXX+X-XX, e llojit apartament, Vol. XXX, faqe XXX, ndodhur në zonën kadastrale me Nr. XXXX, është tjetërsuar përpara regjistrimit të procedimit pasuror, kurse për dy pasuritë e tjera, u provua në hetim ligjshmëria e burimit të krijimit të tyre.

- U provua që familja D. është një familje që është marrë, në vazhdimësi, me aktivitet bujqësor dhe blegtoral dhe nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale, ndër vite, ka përfituar të ardhura të ligjshme.

- U provua se pasuria me Nr. XXX/X, e llojit arë, truall dhe ndërtesë, me sipërfaqe 81 m², në

zonën kasastrale XXXX, është blerë që në vitin 1996, me të ardhurat e tyre të realizuara nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral dhe kontratën e kanë formalizuar në vitin 2011. (Fakt ky që u provua nga pagesa e energjisë elektrike dhe aktet noteriale). Si e tillë, ajo është krijuar para përfshirjes në aktivitet kriminal dhe vlera e blerjes justifikohet nga aktiviteti ekonomik i shtetasve S dhe S.D.

- U provua që pasuria e llojit njësi, me sipërfaqe 32.5 m², me vlerë 54 000 euro, është blerë më të adhurat e akumuluar ndër vite, nga shtetasit S. dhe S.D dhe një pjesë të vlerës të marrë borxh nga shtetasi Q.P. ...”.

4. Pasi nga ana e Prokurorisë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, është marrë vendimi i datës 2.6.2017, më të cilin është vendosur: Pushimi i procedimit pasuror me Nr. XX/X, të vitit 2016, në ngarkim të shtetasave XH.D (D), S.D dhe S.D, shtetasit e mësipërm, kanë paraqitur kërkesë me objekt revokimin e vendimit Nr. 25, datë 2.12.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me të cilin ishte vendosur sekuestroja nga kjo gjykatë, mbi pasuritë e mëposhtme:

1. Pasuri e paluajtshme nr. XX/XXX+X-XX, e llojit Apartament, me adresë, lagja X Plazh, Durrës, vol. XXX fq. XXX, e ndodhur në Zonën kadastrale nr. XXXX, me sipërfaqe 75 m², e cila, figuron në emër të shoqërisë ndërtuese “XXXX”sh.p.k., por që në fakt, është e blerë prej shtetasve S.D.

2. Pasuri e paluajtshme e llojit Njësi, me sipërfaqe 32.5 m², e ndodhur në zonën kadastrale nr. XXXX, lagja 13 Plazh Durrës, e cila, nuk figuron e regjistruar në Z.V.R.P.P. Durrës, dhe ndodhet në një pallat të ndërtuar nga shoqëria “XXXX” Sh.p.k, në truallin e shtetasve SH.A.T, ku, ky truall sipas kontratës së sipërmarrjes, figuron i regjistruar në Z.V.R.P.P. Durrës dhe ka numër pasurie XX/XXX, vol XX , fq XX dhe është blerë nga shtetasi S.D.

3. Pasuri e paluajtshme me Nr. XXX/X, e llojit are + truall, me sipërfaqe 420 m², nga kjo trualli zë 300 m², dhe ndërtesë 81 m², e regj në vol. X fq XXX, zona kadastrale XXXX, ndodhur në XXXXX, Berat, e cila figuron në pronësi të shtetasit S.D.

5. Për kërkesën e paraqitur nga kërkuesit XH.D (D), S.D dhe S.D, me objekt revokimin e vendimit të mësipërm të gjykatës që kishte vendosur sekuestrimin e këtyre pasurive, në bazë të ligjit nr. 1092, datë 03.12.2019 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, të ndryshuar, prokurorja u shpreh që, ishte dakort me pranimin e kërkesës, pasi sipas saj, nuk u arrit që të plotësohen të gjitha kushtet ligjore të kërkuar nga ligji, për konfiskimin e këtyre pasurive.

6. Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga kërkuesit, gjykata vlerëson që, para saj shtrohet për zgjidhje pyetje: Kur gjykata ka disponuar me vendim të veçantë, për sekuestrimin e pasurive, në bazë të ligjit nr. 1092, datë 03.12.2019 dhe organi i prokurorisë vendos pushimin e procedimit pasuror në ngarkim të shtetasit ose shtetasve dhe këta të fundit, pas marrjes së këtij vendimi nga akuza, paraqesin kërkesë për revokimin e vendimit të gjykatës të sekuestrimit të pasurive, cilët janë kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga gjykata, në këtë rast? Gjykata duhet të kufizohet vetëm në anën formale të verifikimit të kërkesave procedurale, nëse, ekziston vendimi i pushimit të procedimit pasuror nga akuza dhe ekzistojnë edhe kushtet e tjera formale, apo gjykata ka të drejtë që të vlerësojë edhe themelin ose meritën e çështjes, duke hetuar dhe gjykuar, nëse, vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit pasuror ka qenë i bazuar në prova dhe ligj?

7. Për këtë pyetje, gjykata vlerëson që, duke i bërë një interpretim literal, teleologjik,

sistematik dhe logjik, të gjitha dispozitave të ligjit të veçantë Nr. 1092, datë 03.12.2019 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, dhe veçanërisht ndryshimeve të bëra këtij ligji, së fundmi, me ligjin nr. 70, të vitit 2017, në shqyrtimin e kërkesave me objekt revokimin e vendimit për sekuestrimin e pasurisë, kur nga ana e akuzës është vendosur pushimi i procedimit pasuror, ***gjykata ka të drejtë dhe detyrë, jo vetëm të konstatojë anën formale të çështjes, por duhet të hetojë dhe të gjykojë mbi themelin ose meritën e zgjidhjes së saj***, duke konkluduar, nëse, nga ana e organit të akuzës vendimi i pushimit të procedimit pasuror, është i bazuar në prova dhe ligj.

8. Nëse, gjykata pas hetimit dhe gjykimit të çështjes, konkludon që, vendimi i prokurorisë për pushimin e procedimit pasuror është i bazuar në prova dhe ligj, ajo duhet të vendosë pranimin e kërkesës së paraqitur nga prokurori ose personat e interesuar për revokimin e vendimit të saj për sekuestrimin e pasurive, duke urdhëruar edhe organet përgjegjëse, për kthimin e tyre tek pronarët e ligjshëm. Në të kundërt, nëse, gjykata konkludon që, vendimi i prokurorisë nuk është i bazuar në prova ose ligj ose është marrë si rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit, ajo vendos rrezimin e kërkesës për revokimin e vendimit për sekuestrimin e pasurive, si dhe kur është e bindur që, plotësohen kriteret për konfiskimin e pasurive të seuestruara, ajo të vendos edhe konfiskimin e tyre.

9. Ky vlerësim i gjykatës është i bazuar nga interpretimi që i bëhet, veç e veç dhe në tërësi të gjitha dispozitave të ligjit të veçantë Nr. 1092, datë 03.12.2019 dhe posaçërisht fjalisë së dytë të pikës 4 të këtij ligji, e cila parashikon:

“Kërkesa e prokurorit për revokimin e sekuestrimit nuk e pengon gjykatën të vendosë sekuestrimin e pasurisë kur ajo çmon se plotësohen kriteret e parashikuar në këtë ligj”.

10. Duke u rikthyer tek çështja konkrete, gjykata, pasi shqyrtoi të gjitha aktet dhe provat mbi të cilat prokuroria kishte vendosur pushimin e procedimit pasuror me Nr. 07/1, të vitit 2016, në ngarkim të shtetasave XH.D (D), S.D dhe S.D, çmon që, vendimi i prokurorisë është i bazuar në prova dhe ligj, pasi edhe në vlerësim të kësaj gjykate, rezulton që, kërkuesit pasuritë e sekuestruara, i kanë siguruar nga të ardhura dhe burime të ligjshme.

11. Gjkata, pasi arriti në këtë përfundim dhe duke mos dashur të përsërisë analizën e provave dhe të ligjit që prokurori ka bërë në vendimin e pushimit të procedimit pasuror, të datës 2.6.2017, vlerëson që, kërkesa e paraqitur nga kërkuesit për revokimin e vendimit Nr. 25, datë 2.12.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me të cilin është vendosur sekuestrimi i pasurive që janë në pronësi të tyre, është e bazuar dhe prandaj do të pranohet nga gjykata.

PËR KËTO ARSYE:

Gjkata bazuar në nenin 13 të ligjit Nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.

VENDOSI:

- 1.** Pranimin e kërkesës së kërkuesve XH.D (D), S.D dhe S.D.
- 2.** Revokimin e masës së sekuestrimit të vendosur me vendimin Nr. 25, datë 2.12.2016 të

Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, mbi pasuritë e mëposhtme:

1. Pasuri e paluajtshme nr. XX/XXX+X-XX, e llojit Apartament, me adresë, lagja X Plazh, Durrës, vol.XXX fq. XXX, e ndodhur në Zonën kadastrale nr. XXXX, me sipërfaqe 75 m², e cila, figuron në emër të shoqërisë ndërtuese “XXXX”sh.p.k., por që në fakt, është e blerë prej shtetases S.D.

2. Pasuri e paluajtshme e llojit Njësi, me sipërfaqe 32.5 m², e ndodhur në zonën kadastrale nr. XXXX, lagja X Plazh Durrës, e cila, nuk figuron e regjistruar në Z.V.R.P.P. Durrës, dhe ndodhet në një pallat të ndërtuar nga shoqëria “XXXX” Sh.p.k, në truallin e shtetases SH.A.T, ku, ky truall sipas kontratës sësipërmarrjes, figuron i regjistruar në Z.V.R.P.P. Durrës dhe ka numër pasurie XX/XXX, vol XX , fq XX dhe është blerë nga shtetasi S.D.

3. Pasuri e paluajtshme nr. XXX/X, e llojit are + truall, me sipërfaqe 420 m², nga kjo trualli zë 300 m², dhe ndërtesë 81 m², e regjistruar në vol. X, fq XXX, zona kadastrale XXXX, ndodhur në Veterik, Berat, e cila figuron në pronësi të shtetasit S.D.

3. Ngarkohet Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave, Tiranë, si dhe zyrat e përmbarimit respektive, pranë vendndodhjes së pasurive të paluajtshme, për ekzekutimin e këtij vendimi dhe kthimin e këtyre pasurive pronarëve ose poseduesve të tyre të ligjshëm.

4. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

5. U shpall, në Tiranë, sot me datë 23.6.2017.

SEKRETARE
LAVDIE HYSAJ

GJYQTAR
LUAN HASNEZIRI

